

WIKIPEDIA

Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave (EFDI) AISBL

Tabela e përmbajtjes

Rreth EFDI-së
Qëllimi i EFDI-së
Komiteti i BE-së
Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun
Grupi i Punës së ICS-së
Grupi i Punës për Zgjidhjen e Krizave
Anëtarësimi në EFDI
 Anëtarët e plotë
 Anëtarët e Asociuar
 Vëzhguesit
Bordi i EFDI-së
Kryetarët e Komitetit dhe pozicionet e tjera
Lidhjet në internet

Informacione të shkurtra rreth EFDI-së

Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave
Forma ligjore: Shoqatë Ndërkombëtare Jofitimprurëse sipas legjislacionit belg (AISBL)
Themeluar më: 2002 (dhe si INPA belge në 2007)
Vendi i themelimit: Bruksel, Belgjikë
Kryetar: Roberto Moretti
Zëvendëskryetar: Dirk Cupei
Kryetar nderi: Suzanne McCarthy
Anëtarët: 68 Skema të Sigurimit të Depozitave dhe Skema të Kompensimit të Investitorëve nga 44 shtete
Faqja e internetit: www.efdi.eu

Rreth EFDI-së

Forumi Evropian i Siguruesve të Depozitave (EFDI) u themelua në fillim në vitin 2002, i mbështetur nga Komisioni Evropian. 25 anëtarë themelues vendosën bashkërisht që të ngrinin një platformë të përbashkët për shkëmbimin reciprok të informacionit. Në qershor 2007, EFDI-ja përshtati formën ligjore të një Shoqate Ndërkombëtare Jofitimprurëse sipas legjislacionit belg (INPA – AISBL). Selia e saj e regjistruar është në Bruksel (B-1000 Brussels, 10 Rue Montoyer, Belgium). Zyrat e kryesisë së EFDI-së dhe të sekretariatit të EFDI-së ndodhen në adresën Via del Plebiscito, 102, 00186 Rome (Itali). Anëtarësia e EFDI-së përfshin tashmë 68 institucione anëtare (57 DGS) dhe Anëtarë të Asociuar (11 ICS) nga një total prej 44 shtetesh nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës (Neni 6, Statutet e EFDI-së).

EFDI-ja ka një marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me akademitë dhe organizatat kryesore evropiane dhe ndërkombëtare, veçanërisht me Komisionin Evropian (KE), Bankën Qendrore Evropiane (BQE), Autoritetin Bankar Evropian (ABE), Bankën Botërore (BB), Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Tryezën e Rrumbullakët të Shërbimeve Financiare Evropiane (TRRSHE), Federata Evropiane e Bankave (EBF) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (IADI).

Qëllimi i EFDI-së

Qëllimi kryesor i EFDI-së është që të kontribuojë në stabilitetin e sistemeve financiare, duke nxitur bashkëpunimin evropian dhe ndërkombëtar në fushat e sigurimit të depozitave, zgjidhjes së krizave dhe kompensimit të investitorëve dhe në lehtësimin e diskutimeve dhe shkëmbimit të njohurive dhe informacionit rreth çështjeve me interes të përbashkët. EFDI-ja angazhohet gjithashtu në diskutimin e temave rregullatore dhe të tjera me interes të përbashkët dhe në shqyrtimin e çështjeve ndërkufitare, duke përfshirë bashkëpunim më të mirë ndërmjet shteteve evropiane dhe duke vendosur kontakte me skemat joevropiane të sigurimit të depozitave. Ajo fokusohet gjithashtu në ekzaminimin dhe zhvillimin e zbatimit në praktikë të Direktivës së BE-së për Skemat e Sigurimit të Depozitave.

EFDI-ja nuk jep prononcime detyruese në emër të anëtarëve të saj. EFDI-ja mund të shprehë opinionin e anëtarëve të saj ose të anëtarëve të një nëngrupi, në varësi të marrëveshjes që është bërë me këta anëtarë. Deklaratat e EFDI-së ose aktivitetet e saj, bëhen pa asnjë paragjykim kundrejt sovranitetit të anëtarëve të saj.

Komiteti i BE-së

EFDI-ja ka ngritur një Komitet të BE-së që përfshin të gjithë anëtarët e saj nga shtetet anëtare të BE-së. Komiteti i BE-së trajton politikën e EFDI-së në lidhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për sigurimin e depozitave, paraqitjen e çdo përgjigjeje ose deklaratë të politikës në Komisionin Evropian (ose te ndonjë institucionin të Bashkimit Evropian ose që ka lidhje me të), raportimin e çdo diskutimi të anëtarëve në lidhje me politikën e EFDI-së te Komisioni Evropian (ose te ndonjë institucionin i Bashkimit Evropian ose që ka lidhje me të) dhe përfaqësimin e EFDI-së përpara Komisionit Evropian (ose te ndonjë institucionin i Bashkimit Evropian ose që ka lidhje me të) në lidhje me politikën e EFDI-së.

Komiteti i BE-së i EFDI-së kryesohet nga kryetari i EFDI-së (Roberto Moretti) (sipas nenit 31, Statutet e EFDI-së). Bordi i EFDI-së ka emëruar Alex Kuczynski si Koordinator të Komitetit të BE-së.

Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun

EFDI-ja ka ngritur gjithashtu një Komitet të Marrëdhënieve me Publikun që përfshin ekspertë të marrëdhënieve me publikun (PR) nga të gjithë vendet anëtare të EFDI-së. Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun trajton të gjitha çështjet që lidhen me këtë fushë për sa i përket mbrojtjes së depozitave dhe kompensimit të investitorëve. Synimet e saj kryesore janë shkëmbimi i përvojës në lidhje me komunikimin gjatë

krizave, si dhe të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për skemat e sigurimit të depozitave në shtetet anëtare të EFDI-së.

Bordi i EFDI-së emëroi Dr. Stephan Rabe si zëdhënës shtypi të EFDI-së. Në këtë funksion, ai drejton gjithashtu edhe Komitetin e Marrëdhënieve me Publikun.

Grupi i Punës i Skemës për Kompensimin e Investitorëve (ICS WG)

ICS WG-ja përbëhet nga 35 institucione, 11 nga të cilat janë Anëtarë të Asociuar (d.m.th. vetëm Skema të Kompensimit të Investitorëve) dhe 24 të tjerët janë edhe Skema të Sigurimit të Depozitave, edhe Skema të Kompensimit të Investitorëve.

ICS WG-ja merret me politikat e EFDI-së lidhur me legjislacionin e Bashkimit Evropian për skemat e kompensimit të investitorëve. Në mënyrë të veçantë, grupi ka ndjekur procesin legjislativ të Direktivës për Skemat e Kompensimit të Investitorëve (97/9/EC –lidhja), duke organizuar takime, duke shkëmbyer pikëpamje dhe duke kërkuar sqarime nga Parlamenti Evropian dhe përfaqësuesit e Komisionit. Nëngrupi ndjek gjithashtu punën e Komisionit Evropian dhe kryen bashkëpunimin e gjerë ndërkombëtar.

Grupi i Punës për Zgjidhjen e Krizave

Grupi i Punës për Zgjidhjen e Krizave analizon dhe i jep rekomandime Bordit të EFDI-së për planet/temat e rikuperimit të bankave dhe të zgjidhjeve, në mënyrë që EFDI-ja të jetë në gjendje t'u përgjigjet dhe të veprojë mbi iniciativat evropiane dhe ato ndërkombëtare për këto çështje. Me rëndësi të veçantë për anëtarët e EFDI-së është lidhja midis DGS-së dhe Fondeve të Zgjidhjes.

Anëtarësia

Anëtarët e plotë

- Shqipëria - [Albanian Deposits Insurance Agency \(ADIA\) http://www.dia.org.al](http://www.dia.org.al)
- Armenia - [Armenian Deposit Guarantee Fund http://www.adgf.am](http://www.adgf.am)
- Austria - Deposit Protection Company of the Austrian Commercial Banks <http://www.einlagensicherung.at>
- Austria - Hypo-Haftungsgesellschaft mbH <http://www.hypoverband.at>
- Austria - Österreichische Raiffeisen-Einlagensicherung reg. Gen. mbH. <http://www.rzb.at>
- Austria - Österreichischer Genossenschaftsverband Schulze - Delitzsch <http://www.oegv.info>
- Austria - Österreichischer Sparkassenverband <http://www.sparkasse.at>
- Azerbajxhani - Deposit Insurance Fund <http://www.adif.az>
- Belgjika - Deposit and financial instrument protection fund www.protectionfund.be

- Bosnja dhe Hercegovina - Deposit Insurance Agency <http://www.aod.ba>
- Bullgaria - Bulgarian Deposit Insurance Fund (BDIF) <http://www.dif.bg>
- Kroacia - State Agency for Deposit Insurance and Bank Rehabilitation <http://www.dab.hr>
- Qipro - Deposit Protection Scheme <http://www.centralbank.gov.cy>
- Republika Çeke - Deposit Insurance Fund <http://www.fpv.cz>
- Danimarka - The Danish Guarantee Fund for Depositors and Investors managed by the Financial Stability Company <http://www.indskydergarantifonden.dk>
- Estonia - Guarantee Fund <http://www.tf.ee>
- Finlanda - The Deposit Guarantee Fund <http://www.talletussuojarahasto.fi>
- Franca - Fonds de Garantie des Dépôts – FGD – (Deposit Guarantee and Investors Guarantee fund) <http://www.garantiedesdepots.fr>
- Gjermania - Deposit Protection Fund <http://www.bdb.de>
- Gjermania - Depositor Compensation Scheme of the Association of German Public Sector Banks GmbH <http://www.voeb.de>
- Gjermania - Deposit-Protection Fund of the Association of German Public Sector Banks e.V. <http://www.voeb.de>
- Gjermania - German Saving Banks Association <http://www.dsgv.de>
- Gjermania - National Association of German Cooperative Banks <http://www.bvr.de>
- Gjermania - The German Private Commercial Banks Compensation Scheme for Investors <http://www.edb-banken.eu>
- Greqia - Hellenic Deposit and Investment Guarantee Fund (HDIGF) www.hdigf.gr
- Hungaria - National Deposit Insurance Fund of Hungary (NDIF) <http://www.oba.hu>
- Islanda - Icelandic Depositors and Investor Guarantee Fund <http://www.tryggingarsjodur.is>
- Irlanda - Irish Deposit Protection Scheme <http://www.centralbank.ie>
- Italia - Bond Holders Guarantee Fund of Cooperative Credit Banks <http://www.fgo.bcc.it>
- Italia - Deposit Protection Fund for Co-operative Banks <http://www.fgd.bcc.it>
- Italia - Interbank Deposit Protection Fund <http://www.fitd.it>
- Xhersi - Finance Industry Development - Economic Development <http://www.gov.je>
- Lituania - Financial and Capital Market Commission of Latvia <http://www.fktk.lv/en>
- Lihtenshtajni - The Liechtenstein Bankers Association www.bankenverband.li
- Lituania - Deposit and Investment Insurance <http://www.iidraudimas.lt/>
- Luksemburgu – Deposit Guarantee System <http://www.agdl.lu>
- Maqedonia - Deposit Insurance Fund <http://www.fodsk.org.mk>
- Malta – Depositor Compensation Scheme <http://www.compensationschemes.org.mt>
- Mali i Zi – Deposit Protection Fund <http://www.fzdcg.org>
- Holanda - Collective guarantee scheme of credit institutions for repayable funds and portfolio investments <http://www.dnb.nl>
- Norvegjia - Bank Guarantee Fund <http://www.bankenessikringsfond.no>

- Polonia - Bank Guarantee Fund <http://www.bfg.pl>
- Polonia - TUW SKOK <http://www.skok.pl>
- Portugalia - Fundo de Garantia do Credito Agricola Mutuo www.fgcam.pt
- Portugalia – Deposit Guarantee Fund <http://www.fgd.pt>
- Rumania - Bank Deposit Guarantee Fund <http://www.fgdb.ro>
- Rusia - Deposit Insurance Agency <http://www.asv.org.ru/en>
- San Marino - Central Bank of San Marino <http://www.bcsn.sm>
- Serbia - Deposit Insurance Agency <http://www.aod.rs>
- Sllovakia - DepositProtection Fund <http://www.fovsr.sk>
- Sllovenia - Banka Slovenije <http://www.bsi.si>
- Spanja –Deposit Guarantee Fund of Credit Institutions <http://www.fgd.es>
- Suedia – Deposit Guarantee Board <http://www.riksdagen.se>
- Zvicra - Deposit Protection of Swiss Banks and Securities Dealers <http://www.garantie-des-depots.ch>
- Turqia - Savings Deposit Insurance Fund <http://www.tmsf.org.tr>
- Ukraina - Bank Deposit Guarantee Fund <http://www.fg.gov.ua>
- Mbretëria e Bashkuar - Financial Services Compensation Scheme (FSCS) <http://www.fscs.org.uk>

Anëtarët e Asociuar

- Bullgaria - Investor Compensation Fund <http://www.sfund-bg.com>
- Kroacia - Central Depository & Clearing Company Inc. <http://www.skdd.hr>
- Republika Çeke - Garanční fond obchodníků s cennýmipapíry <http://www.gfo.cz>
- Finlanda - The Finnish Deposit Guarantee Fund - Federation of Finnish Financial Services <http://www.fkl.fi/en>
- Hungaria - Investor Protection Fund <http://www.bva.hu>
- Irlanda - The Investor Compensation Company Limited <http://www.investorcompensation.ie>
- Italia - National Guarantee Fund <http://www.fondonazionaledigaranzia.it>
- Norvegjia - Norwegian Investor Compensation Scheme, <http://www.fno.no/en/Home/>
- Portugalia - Investor compensation scheme <http://www.cmvm.pt>
- Rumania - Investor Compensation Fund <http://www.fond-fci.ro>
- Turqia - Turkish Investor Compensation Scheme <http://www.mkk.com.tr>

Vëzhguesit

- Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare
- Autoriteti Bankar Evropian
- Tryeza e Rrumbullakët e Shërbimeve Financiare Evropiane
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
- Federata Evropiane e Bankave
- Banka Qendrore Evropiane
- Komisioni Evropian
- Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave

- Fondi Monetar Ndërkombëtar
- Banka Botëror
- Instituti Botëror i Bankave të Kursimit aishl /Grupi Evropian i Bankave të Kursimit aishl
- Komisioni Evropian – Qendra e Përbashkët e Kërkimeve

Bordi i EFDI-së

Kryetar: Roberto Moretti (Itali)
 Nënkryetar: Dirk Cupei (Gjermani)
 Drejtor i Thesarit: Helmut Starnbacher (Austri)

Anëtarë të tjerë të Bordit:
 Andras Fekete-Gyor (Hungari)
 Francois de Lacoste Lareymondie (Francë)
 Andrey Pekhterev (Rusi)
 Patrick Loeb (Zvicër)

Kryetar i Komitetit të BE-së: Roberto Moretti (Itali)
 Koordinator i Komitetit të BE-së: Alex Kuczynski (MB)

Kryetar i Grupit të Punës për ICS: Dirk Cupei (Gjermani)
 Koordinator i Grupit të Punës për ICS: Johanna Palin (Finlandë)
 Zëdhënës shtypi: Dr. Stephan Rabe (Gjermani)
 Sekretariati: Debora Poli (Itali)

Lidhjet në internet

www.efdi.eu

Statutet e EFDI-së <http://www.efdi.eu/documents.asp?Id=2&Cat=Statutes>

Memorandumi i Mirëkuptimit i EFDI-së
<http://www.efdi.eu/documents.asp?Id=11&Cat=Efdi%20EU%20committee%20public%20documents>

Lidhja me direktivat 94/19/EC dhe 2009/14/EC
<http://www.efdi.eu/documents.asp?Id=1&Cat=Directives>

Lidhja me direktivën 97/9/EC
<http://www.efdi.eu/documents.asp?Id=1&Cat=Directives>